



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/343
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I63-4

Prot.

Tiranë _10_/12//2025

Nr. Dok. 202503246/2

Lënda : Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të dënuarve dhe paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës.

Drejtuar : Z. Klevis QOSE
Drejtore i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Indrit CERLOJ
Drejtore i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës

DURRËS

Të nderuar,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet e inspektimit që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Durrës më datë 31.07.2025.

Inspektimi në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës, u zhvillua nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

Inspektimi u krye sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Ahmet Prençi, Komisioner i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, z. Hazbi Selita dhe z. Vullnet Topalli me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Objekti kryesor i këtij inspektimi ishte vlerësimi i kushteve të IEVP Durrës, për garantimin e sigurisë, jetës, shëndetit dhe krijimin e ambienteve rekreative me qëllim rehabilitimin dhe ri-integrimin e personave që vuajnë dënimin në burgje, trajtimi dhe respektimi i të drejtave të të burgosurve të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Gjatë vizitës monitoruese, grupit të inspektimit ju ofrua mundësia që të kishin akses të plotë në këqyrjen dhe administrimin e dokumentacionit të kërkuar, inspektimin dhe evidentimin e kushteve ku mbahen dhe trajtohen të dënuarit dhe paraburgosurit në këtë institucion, ambientet e banimit, vendet e ajrimit, dhomat e observimit dhe të veçimit, në ambientin e infermierisë, klasat e edukimit, kuzhinë, lavanderi etj., si dhe bënë këqyrjen e dokumentacionit që administrohej nga punonjësit sipas sektorëve të institucionit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit të MKPT-së, ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë gjetjet e inspektimit si më poshtë vijon:

Shënime paraprake

Vizita inspektuese në IEVP Durrës, u zhvillua në kuadër të inspektimeve periodike që zhvillon MKPT në institucionet ku privohet liria e personit, në mënyrë të paparalajmëruar në bazë të kompetencave të parashikuara në ligjin nr.81/2020, *“Për të drejtat e dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*.

Grupi i inspektimit bazuar në metodologjinë e inspektimit në burgje, zhvilloi paraprakisht një takim me drejtuesit e institucionit të cilët u njohën me qëllimin e inspektimit¹.

Gjithashtu, grupi i inspektimit kërkoi vënien në dispozicion të kopjeve të praktikave të punës që ndiqen nga sektori juridik, sektori psiko-social, sektori i shërbimit shëndetësor, kopje të organikës së institucionit, si dhe të informacioneve të dërguara Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nga sektori ekonomik dhe ai i burimeve njerëzore, në lidhje me planifikimin e fondeve për investime në godinat e banimit në regjimin e brendshëm etj.

Drejtuesit e institucionit informuan për respektimin e të drejtave të të burgosurve, plotësimin e kushteve infrastrukturore në regjimin e brendshëm, si dhe për aktivitetet që zhvillohen me të burgosurit me qëllim rehabilitimin e tyre. Gjithashtu, grupi i inspektimit u informua edhe në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të MKPT-së në inspektimin e mëparshëm.

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës është kategorizuar si institucion i sigurisë së zakonshme me një seksion paraburgimi, si dhe një seksion të veçantë për

¹ Inspektimi i kryer me datë 31.07.2025, ku u takuam me drejtorin në detyrë të institucionit z. Ervis Dedej dhe shefin e Policisë në detyrë z. Gëzim Gjoni.

të dënuar dhe të paraburgosur me probleme të shëndetit mendor (SKV), me kapacitet fizik prej 300 persona të ndarë në 7 sektorë, mesatarisht 14 dhoma për çdo sektor.

Në datën e inspektimit, në këtë institucion vuanin dënimin 222 persona, nga të cilët 56 persona të dënuar dhe 166 persona të paraburgosur. Institucioni kishte gjithashtu edhe një seksion të kujdesit të veçantë (SKV) ku trajtoheshin 56 persona të dënuar/paraburgosur me probleme të shëndetit mendor. Sektori i observimit kishte 2 dhoma, ndërsa sektori i veçimit kishte 3 dhoma.

Grupi i inspektimit, mori informacion për situatën e popullimit në këtë institucion dhe për periudhën Shkurt – Korrik 2025, e cila rezultoi të ishte si më poshtë vijon:

- Muaji Shkurt - 237 të burgosur/183 të p/b, 54 të dënuar
- Muaji Mars - 242 të burgosur/187 të p/b, 55 të dënuar
- Muaji Prill - 272 të burgosur/218 të p/b, 54 të dënuar
- Muaji Maj - 240 të burgosur/185 të p/b, 55 të dënuar
- Muaji Qershor - 224 të burgosur/189 të p/b, 55 të dënuar
- Muaji Korrik - 222 të burgosur/166 të p/b, 56 të dënuar

Ndonëse në institucion nuk ka mbipopullim në numrin e përgjithshëm të të burgosurve referuar kapaciteteve të institucionit, në ditën e inspektimit rezultoi një numër shumë i lartë i të dënuarve, për këtë arsye vlerësojmë se duhet të shikohet mundësia e rishpërndarjes së të dënuarve në IEVP-të të cilat janë të kategorizuara për të dënuarit dhe të rikategorizohet IEVP Durrës vetëm si institucion paraburgimi.

Referuar statistikave dhe informacionit të marrë përgjatë inspektimit, nuk u evidentua që institucioni të ketë patur situata mbipopullimi apo raste të personave që të flenë me dyshekë të vendosur në tokë. Gjithashtu, grupi i inspektimit konstatoi se, në dhomat e banimit ishin të akomoduar nga 2 deri në 4 të burgosur, të cilët ishin të pajisur me krevat dhe materiale fjetje.

Për sa më sipër, mjediset që u ofrohen të burgosurve dhe në veçanti mjediset e fjetjes duhet të respektojnë dinjitetin njerëzor dhe, sa më shumë të jetë e mundur, privatësinë, si dhe të plotësojnë kërkesat shëndetësore dhe higjienike, duke u kushtuar rëndësinë e duhur kushteve të klimës, hapësirës së nevojshme, përmbajtjes kubike të ajrit, ndriçimit, ngrohjes dhe ajrimit².

Në regjimin e brendshëm të IEVP-së, të burgosurit ishin akomoduar në 2 godina banimi, të ndara sipas sektorëve. Godina “A” përbëhej nga 3 kate dhe kishte në total 5 sektorë, ku kati i parë ishte me 1 sektor, ndërsa kati i dytë dhe i tretë me nga 2 sektorë banimi. Ndërsa godina “B” ishte 2 kate, ku secili kat kishte nga 1 sektor për akomodimin e të burgosurve.

²Neni 33, të ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Ambientet ndihmëse për sektorin shëndetësor, sektorët e shërbimeve si kuzhina, lavanderia, dhomat e takimit me avokatët mbrojtës dhe prokurorët e çështjes, postet e takimit me familjarët, klasat dhe bibliotekat, janë funksionale dhe përgjithësisht sipas standardeve të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore. Këto ambiente, ndodhen në katin e parë të godinës “A” në regjimin e brendshëm.

Struktura organike e institucionit ishte e miratuar me urdhërin nr. 68, datë 30.04.2024 të Kryeministrit të RSH “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve të varësisë së saj*”. IEVP Durrës kishte në organikë 53 punonjës civil dhe 152 punonjës policie. Aktualisht ishin 52 punonjës civil dhe 142 punonjës policie. Nga informacioni mbi vendet vakante sipas organikës në këtë institucion, rezultoi se:

- Në stafin civil mungonte 1 kuzhiner, në sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.
- Në sektorin e policisë mungonin 10 punonjës, 3 punonjës të rolit të mesëm (PRM) dhe 7 punonjës të rolit bazë (PRB). Sipas informacionit, mungesat në staf nuk ndikonin në dhënien e shërbimeve dhe sigurinë e të burgosurve, por lind nevoja e plotësimit sa më parë të vendeve vakante.

Nisur nga informacioni i drejtorit të institucionit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm³, rezultoi se:

1. Ishte zbatuar rekomandimi, për miratimin sa më parë të Rregullores së Brendshme të IEVP-së Durrës nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.
2. Ishte zbatuar rekomandimi, për hidroizolimim e plotë të tarracës së godinës në regjimin e brendshëm të institucionit, për eliminimin e lagështirës në ambientet e brendshme të banimit.
3. Ishte zbatuar rekomandimi, për plotësimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha posteve të dusheve për të bërë të mundur aksesimin me ujë të ngrohtë për larjen e trupit për të gjithë të dënuarit/paraburgosurit, si dhe zëvendësimin dhe plotësimin sipas nevojave në ambientet e banimit me materiale të reja të buta.
4. Ishte zbatuar rekomandimi, për pajisjen e institucionit me një autoambulancë për rastet emergjente të të sëmurëve dhe shoqërimin në Spitalin Rajonal Durrës apo Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.
5. Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi, për shtimin e ambienteve të përbashkëta me qëllim rritjen e numrit të aktiviteteve në mënyrë që të paraburgosurit/dënuarit, të kenë aktivitete të shumta edukative, sportive dhe të mundësohet që të zhvillojnë edhe aktivitete tjera, me të cilat shprehin talentin në punën dhe zanatat që zotërojnë.
6. Ishte zbatuar rekomandimi, për përmirësimin e punës së sektorit juridik dhe ndërveprimin e tij me të burgosurit lidhur me kërkesat e tyre.

³ Rekomandimi i dërguar me nr. K4/I76-2 prot., datë 03.12.2024.

Ndërkohë, një pjesë e rekomandimeve të paraqitura nga Avokati i Popullit nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar. Më konkretisht:

1. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për zbatimin e planit të rikonstruksionit për shkak të nevojave emergjente dhe të qënësishme që shfaqen në këtë institucion dhe që janë evidentuar tashmë edhe nga Akt Ekspertiza e Thelluar nga Drejtoria e Konformitetit, Akt Ekspertizës dhe Projekteve, të Institutit të Ndërtimit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
2. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për përmirësimin e cilësisë së ushqimit dhe larmishmërisë së tij.
3. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për marrjen e masave për instalimin e një sistemi qendror për ngrohje/ftohje të ambienteve të brendshme të dhomave të banimit të të dënuarve/paraburgosurve dhe për heqjen e pajisjeve ngrohëse elektrike, të cilat përbëjnë rrezik për jetën e këtyre personave.
4. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për vendosjen e mbulesave të bokseve të ajrimit, për të ndaluar futjen e ujit në kohë me shi.
5. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, nga sektori i sigurisë të institucionit, për heqjen e litarëve në dhomat e banimit që përdoren nga të dënuarit/paraburgosurit për tharjen e rrobave, si element që cënon sigurinë, por edhe si mjet që mund të përdoret për dëmtimin e jetës, kryesisht nga persona që kanë probleme me shëndetin mendor dhe krijimin e një lavanderie për këtë qëllim.

Vizita inspektuese në këtë institucion u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi dhe grupit të MKPT-së ju ofruan të gjitha lehtësitat për kryerjen e inspektimit, këqyrjen e ambienteve në regjimin e brendshëm, si dhe zhvillimin e intervistave me të burgosurit pa mbikëqyrjen e stafit të sigurisë së institucionit, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Trajtimi i të burgosurve

Gjatë vizitës monitoruese, grupi inspektues vizitoi dhe kontaktoi me të burgosurit në të gjitha ambientet e IEVP Durrës, me qëllim mbledhjen e informacionit lidhur me garantimin e të drejtave dhe trajtimin e personave që vuajnë dënimin në këtë institucion, identifikimin e rasteve të dhunës, përdorimin e forcës fizike tej kufijve të parashikuar në aktet normative apo ushtrimit të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, mënyrën e trajtimit dhe zgjidhjes së kërkesë/ankesave të të burgosurve, procedurat që ndiqen nga komisioni për pritjen e tyre në institucion, komisioni për dhënien e masave disiplinore, aktivitetet e zhvilluara, trajtimin shëndetësor të të dënuarve, cilësinë e ushqimit, furnizimin sipas normativave me detergjente dhe mjete të higjienës personale etj.

Nga intervistat e zhvilluara me të dënuarit dhe të paraburgosurit, grupi i inspektimit nuk evidentoi raste apo pretendime për keqtrajtime dhe tejkallim të forcës fizike nga punonjësit e këtij institucioni. Sikurse ata pohuan, marrëdhëniet e stafit me të burgosurit janë të mira dhe korrekte.

U verifikuan gjithashtu praktikat e punës të sektorit ligjor dhe procedurat që zbatohen nga Komisioni i Disiplinës së institucionit, në procesin e marrjes së vendimit për dhënien e masave disiplinore të lehta dhe të rënda ndaj të burgosurve, në përputhje me shkeljet disiplinore të kryera nga ana e tyre.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezultoi se rregullat e disiplinës në këtë institucion zbatoheshin në përshtatje me moshën, gjendjen fizike, psikike e psikologjike të të burgosurve, me qëllim stimulimin e ndjenjës së përgjegjësisë dhe aftësinë e vetëkontrollit të të burgosurve, dhe jo duke i konsideruar ato thjesht e vetëm si masa ndëshkuese⁴.

Godinat në regjimin e brendshëm dhe infrastruktura e institucionit, garantonin sigurinë dhe kushtet e qëndrimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve, për kryerjen e veprimeve sipas orarit ditor, si dhe ofronin mundësi për të përballuar dinamikën e hyrjeve të reja dhe transferimit të të burgosurve në I EVP-të e tjera, situatë kjo që ndryshonte çdo ditë në varësi të vendimeve të gjykatave.

Gjatë inspektimit, u evidentua se prej qershorit 2025, I EVP Durrës ishte nënshtruar rikonstruksionit për përmirësimin e kushteve të jetesës për të burgosurit, si hidroizolimi i plotë të godinave të banimit, me qëllim eliminimin e lagështirës së theksuar të këtij institucioni, sistemin e rrjetit të brendshëm të furnizimit me ujë, instalimet elektrike dhe hidraulik, si dhe shkarkimin e ujërave të bardha dhe të zeza, rregullimin dhe funksionimin e dusheve të përbashkëta etj. Gjithashtu, punimet kishin përfunduar në katin e 2-të dhe 3-të, të godinës “A”, ndërsa në katin e 1-rë vijonin ende me qëllim përmirësimin e kushteve të jetës të të burgosurve. Projekti për këtë investim ishte bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për riparimin e plotë të ambienteve të këtij institucioni.

Institucioni i Avokatit të Popullit, vlerëson hapat e ndërmarrë nga DPB-ja për kryerjen e këtij investimi, në mënyrë që të plotësojnë standardet për garantimin e sigurisë, kushteve të përshtatshme higjieno-sanitare dhe të mundësojnë zhvillimin e veprimtarive të të burgosurve, në përputhshmëri të plotë me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Dhomat e banimit të të dënuarve/paraburgosurve, ishin të pajisura me tualete dhe lavamanë. Në dhomat e banimit kishte një rishpërndarje të përkohshme brenda sektorëve, duke bërë të mundur ruajtjen e kapaciteteve sipas ndarjes së tyre. Ndërkohë, në çdo sektor kishte ambiente të përbashkëta që shërbenin si tualete dhe dushe për larjen e të burgosurve.

Gjatë inspektimit, në këtë institucion u evidentuan ankesa lidhur me mosfunksionimin e sistemit qendror ngrohje/ftohje të ambienteve të banimit, për t’iu përshtatur kushteve

⁴ Nenet 60-67 të ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

klimaterike. Në mungesë të tij, ngrohja/ftohja në dhoma kryhej me pajisje të siguruara nga vetë të dënuarit/paraburgosurit.

Gjithashtu, pothuajse të gjithë të burgosurit ngritën ankesa për cilësinë dhe mungesën e larmisë së ushqimit, si dhe për mungesën e aktiviteteve të zhvilluara brenda institucionit.

Një nga shqetësimet e ngritura në intervistat me të paraburgosurit dhe të dënuarit ishte mungesa e një ambienti më vete për tharjen e rrobave, i cili sillte për pasojë tharjen e rrobave brenda dhomave të banimit, duke përdorur mjete të tilla si kordona apo litarë për varjen dhe tharjen e tyre. Mbajtja e kordoneve apo litarëve në dhomat e banimit përbën rrezik për jetën e të dënuarve dhe të paraburgosurve në këtë institucion.

Në këtë institucion ka një sektor ku ndodhen të akomoduar disa të paraburgosur apo të dënuar për të cilët ka plane të posaçme mbrotje apo sigurie si ish prokuror apo ish drejtues të lartë institucioneve shtetërore.

Masat mbrojtëse

Nga intervistimi me të dënuarit/paraburgosurit dhe me stafin e këtij institucioni, u kërkuar informacion në lidhje me funksionimin e sistemit të kërkesë/ankesave. Rezultoi se sistemi i kërkesë/ankesave funksionon mbi bazën e urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve⁵, ku përcaktohen personat përgjegjës të autorizuar të cilët në mënyrë periodike marrin kërkesë/ankesat e të dënuarve/paraburgosurve, kryejnë regjistrimin në regjistrin përkatës, protokollimin e tyre, si dhe trajtimin dhe kthimin e përgjigjes brenda afatit të përcaktuar nga titullari i institucionit. Ky regjistër, ruhet dhe administrohet nga sekretaria e institucionit.

Të paraburgosurit/dënuarit plotësonin një formular kërkesë/ankesë dhe ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit psiko-social. Punonjësi i dërgonte në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje në një kohë sa më të shpejtë.

Për periudhën Janar-Korrik 2025 në sekretarinë e institucionit ishin regjistruar në regjistër **208 kërkesë/ankesa nga të burgosurit**. Sipas shënimeve në regjistër, si dhe informacionit të drejtorit dhe stafit të institucionit, objekti i këtyre kërkesave, kryesisht konsiston në kërkesa për takim me drejtorin e institucionit, takime me familjarët/biseda në platformën online “Microsoft Teams”, kërkesa për punësim, kërkesa për vizita mjekësore te mjeku specialist, kërkesa për takim në dhomën e prindërimit, kërkesa për blerjen e pajisjeve si TV, frigorifer etj.

⁵ Neni 58, pika 5 e ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Në vijim, grupi i inspektimit, kërkoi informacion në lidhje me pritjen e të dënuarve/paraburgosurve në institucion, funksionimin e komisionit të pritjes⁶, si dhe me plotësimin e regjistrave dhe dosjeve personale të tyre. Nga intervista me drejtorin dhe stafin e institucionit, u konstatua se procedura e pranimit në institucion zbatohet në mënyrë korrekte. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se, procedura e ndjekur nga komisioni i pritjes regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej në sekretarinë e institucionit.

Ambienti i takimeve fizike me familjarët ndodhej në katin e parë të godinës, i ndarë më vete për personat e dënuar dhe për të paraburgosurit. Në të njëjtin ambient ndodhej dhoma me kompjuter për komunikim online në platformën Microsoft Teams, 2 dhoma prindërimi për takimin e të burgosurve me familjarët e tyre, 7 poste për takime fizike, dhe 2 dhoma për takime me avokatët mbrojtës dhe prokurorët.

Dhomat për prindërimin në distancë ishin të lyera dhe të pajisura me orëditë minimale, si tavolinë dhe karrige, ku të burgosurit mund të qëndronin ulur, duke patur kontakte të drejtpërdrejta me fëmijët e tyre. Por ambiente janë jo të pastra dhe me kapacitet të kofizuara për takime.

Nga intervistat me të burgosurit, u evidentua se takimet me familjarët zhvilloheshin 4 herë në muaj, nga të cilat 3 takime fizike dhe 1 takim online, kjo në varësi dhe të kërkesës të të burgosurit. Veç takimeve fizike, të burgosurit familjarë mund të zhvillonin edhe takime në dhomat e prindërimit në distancë, të dedikuara për këtë qëllim.

Komunikimi me telefon i të burgosurve me familjarët zhvillohej të paktën 8 herë në muaj, sikurse është e përcaktuar edhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Aparatët telefonik, ishin të instaluar në korridoret e secilit sektor në regjimin e brendshëm dhe në ambientin e ajrimit. Aparatët ishin në gjendje pune dhe nga intervistat të burgosurit ata deklarorin se flisnin me familjarët e tyre rregullisht të paktën 2 herë në javë.

Nga intervistat me të burgosurit, nuk pati ankesa për mosrespektimin e numrit të takimeve me familjarët, apo zëvendësimin e takimeve fizike me takime online me familjarët.

Grupi i inspektimit, verifikoi komunikimin me telefon me Institucionin e Avokatit të Popullit, në numrat e kontaktit që ishin të afishuar në korridorin e IEVP-së. Nga verifikimi rezultoi se, të burgosurit mund të komunikorin në çdo kohë dhe pa pagesë me institucionin e Avokatit të Popullit, sikurse parashikohet në ligjin nr. 81/2020, “Për

⁶ Neni 16 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve parashikon se: “Komisioni i pritjes përbëhet nga një përfaqësues i sektorit ligjor, një përfaqësues i sektorit të çështjeve shoqërore, një përfaqësues i shërbimit shëndetësor dhe një përfaqësues i shërbimit të sigurisë”.

të drejtat e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Personat e moshës 18-21 vjeç **nuk** ishin të akomoduar në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualin e sigurisë për këta persona, por ata ishin të shpërndarë në dhoma me të burgosurit e tjerë. Nga informacioni i drejtuesve të institucionit, sistemimi i tyre në dhoma të veçanta, ishte i pamundur për shkak të mospërshtatjes dhe familjarizimit që ata kishin me të burgosurit e tjerë. Ajrimi dhe veprimtaritë me karakter sportiv dhe edukativ, vijonin të zhvilloheshin me grupe të ndarë sipas grup moshave dhe interesave të të burgosurve.

Në IEVP Durrës, organika e të punësuarve të burgosur kishte të miratuar 16 persona dhe në listëpagesën e muajit të fundit rezultonin të punësuar 14 të burgosur në pozicione pune si sanitar, nd/kuzhinier, mirëmbajtjes, berber etj. Institucioni kishte lidhur kontratat e punës me të punësuarit dhe pagesat kryheshin çdo muaj, duke i derdhur në numrat e llogarive të të punësuarve në bankat e nivelit të dytë.

Avokati i Popullit kërkon plotësimin e menjëhershëm të organikës të të punësuarve me të burgosur, pasi vlerëson krijimin e mundësive për punësimin e personave të burgosur, në kuadër të garantimit të fitimit, ruajtjes dhe zhvillimit të aftësive për punë dhe njohurive profesionale, për ri-integrimin në shoqëri pas përfundimit të kryerjes së dënimit.

Ndërkohë, kishte ankesa dhe pretendime lidhur me kohëzgjatjen dhe zvarritjen e proceseve gjyqësore. Në lidhje me këto ankesa, të intervistuarve ju bë me dije nga grupi i inspektimit se, pavarësisht se këto ankesa nuk janë në juridiksionin dhe kompetencën e MKPT-së, ato do t’ju adresohen nga ana jonë autoriteteve shtetërore përgjegjëse nëpërmjet Seksionit të Veçantë.

Gjithashtu, nga biseda e zhvilluar me një të paraburgosur, u ngrit shqetësimi lidhur me trajtimin e tij gjatë shoqërimit me automjetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nga IEVP Durrës në një klinikë spitalore private në Durrës. Nga intervista, u vu re një ngarkesë emocionale e të paraburgosurit, e cila ishte shkaktuar për shkak të prezencës të shumë të punonjësve të policisë përgjatë vizitës mjekësore brenda dhomës së mjekut pa asnjë lloj shkak.

Në vijim të pretendimeve të sipërpërmendura institucioni i Avokatit të Popullit ndërmori një hetim administrativ për të adresuar ankesën.

Me shkresën nr. 474 prot., datë 13.08.2025 i jemi drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB). “*Kërkesë për informacion*” dhe shkresën nr. 476/1 prot., datë 16.09.2025 “*Kërkesë e përsëritur për informacion*”.

Në përgjigje të shkresave tona, DPB na informoi se shtetasi është shoqëruar në shtabin privat të qytetit të Durrësit më datë 17.7.2025, sipas rekomandimeve të sektorit të shëndetësisë për realizimin e një ekzaminimi imazherik (koloskopi). Shoqërimi është kryer me Urdhrin nr. Sh-17081/, datë 16.07.2025, bashkëshoqëruar me plan masash

standarde për mbarëvajtjen e sigurinë e shërbimit. Për këtë shërbim janë planizuar 8 punonjës policie të rolit bazë, dy drejtues automjesh dhe një oficer drejtues i shërbimit.

Ky planizim paraprak është kryer me arsyetimin e garantimit të sigurisë gjatë udhëtimit, sigurimin e mjeteve në parking të përshtatshëm, sigurimin perimetrik të Objektit/Spital, sigurimin e ambienteve ku do kryheshin vizita/ konsulta/ekzaminime nga kati në kat i godinës etj.

Ndër të tjera DPB na informoi se ky i paraburgosur nuk paraqet rrezikshmëri të lartë dhe për këtë arsye nuk është aplikuar shoqërimi me mbështetjen e shërbimeve nga Policia e Shtetit sipas marrëveshjes⁷ midis këtyre institucioneve, kryesisht në rastet kur i burgosuri vlerësohet me rrisht të lartë.

Për sa më sipër, Institucioni i Avokatit të Popullit kërkon përmirësim të trajtimit të të burgosurve gjatë transportit me automjet por edhe i parashikimit të rregullave dhe procedurave më të qarta në rastet kur të paraburgosurit kryejnë ekzaminime mjekësore duke ruajtur privatësinë shtetasve të privuar nga liria gjatë kryerjes së procedurave shëndetësore në këtë drejtim, si dhe trajnimi i punonjësve pjesë e grupeve të shoqërimit, do të përmbushte më mirë qëllimin e ligjit nr. 81/2020, *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, që sipas nenit 2 është garantimi i kushteve për trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, respektimi i të drejtave dhe të lirive themelore të tyre dhe parandalimi i sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues apo degradues.

Ndërkohë, sistemi i kamerave ishte funksional. Ato mbajnë në vëzhgim ambientet në regjimin e brendshëm dhe të jashtëm gjatë 24 orëve, pamjet e të cilave monitorohen nga salla operative e IEVP-së. Pamjet filmike ruhen në server për një afat 30 ditë dhe administrohen nga specialisti i IT.

Kushtet materiale

Infrastruktura e godinave të banimit, godinave të shërbimeve dhe vendet e ajrimit në regjimin e brendshëm të IEVP Durrës, mesatarisht plotëson kushtet e nevojshme për jetesë të të burgosurve, zhvillimin e aktiviteteve me karakter kulturor dhe sportiv, ajrimin, si dhe garantojnë elementët e sigurisë fizike për ruajtjen e jetës dhe shëndetit të të burgosurve, të cilët vuajnë dënimin në këtë institucion.

Grupi i inspektimit, në fokus të vizitës së tij pati një interes të veçantë në plotësimin e kushteve materiale që janë në funksion të të dënuarve/paraburgosurve, për respektimin e standardeve normale të jetesës dhe për zhvillimin e aktiviteteve me karakter kulturor, edukativ dhe sportiv.

⁷ Marrëveshja me nr. 2194 prot., datë 05.03.2019 e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe nr. 897/3 prot., datë 04.03.2019 të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

IEVP Durrës, ndodhet jo shumë larg qendrës së qytetit të Durrësit, në një vend të populluar dhe lehtësisht të aksesueshëm me mjetet e transportit publik. Por ndërtesat e banimit janë shumë pranë I EVP-së.

Ndërtimi i burgut në një zonë të populluar dhe rrethimi i tij nga ndërtesa civile cënon elementët e sigurisë. Gjithashtu, kjo zonë duke qenë se është një zonë ujëmbajtëse, në ditët kur ka reshje të dendura shiu, pothuajse të gjitha ambientet që ndodhen në katin e parë të institucionit përmythen duke përhapur lagështirën në të gjithë infrastrukturën e regjimit të brendshëm.

IEVP Durrës përbëhet nga dy godina A dhe B. Situata në këto godina paraqitet si më poshtë:

Godina A përbëhet nga 3 kate, ku në katin e parë ishin dhomat e observimit, veçimit, dhoma e mjekëve, stomatologut, infermierëve, palestra, 5 dhoma banimi dhe një SKV. Në katin e dytë, në sektorin e dytë janë të akomoduar të dënuar me probleme të shëndetit mendor dhe probleme shëndetësore. Kapaciteti i këtij sektori ishte 14 dhoma me nga 4 krevatë, ku në total mund të akomodohej 56 persona. Ndërsa në sektorin e parë të katit të dytë dhe në dy sektorët e katit të tretë ishin akomoduar të paraburgosur të tjerë. Secili sektor përbëhet nga 14 dhoma me nga 2 deri 4 shtretër secila. Sikurse e theksuam edhe më lart, godina ishte në proces të rikonstruksionit me qëllim garantimin e shëndetit dhe sigurisë të jetës të të burgosurve.

Avokati i Popullit kujton që ka shumë rëndësi që projektet të sigurojnë përputhshmëri të plotë me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Dhomat e banimit ishin të kompletuara me materiale për fjetje si dyshekë, batanije, jastëk dhe çarçafë, të cilat ishin në gjendje të mirë përdorimi. Dhomat e banimit në këtë godinë kishin sipërfaqe rreth 4.2mx3m.

Godina B përbëhet nga 2 sektorë. Në katin e parë të kësaj godine ndodhet sektori A, ku ishin akomoduar të dënuarit e kategorisë “moshë e tretë” dhe të sëmurët kronikë. Në katin e dytë të kësaj godine ndodhet sektori B ku ishin akomoduar të paraburgosurit. Dhomat në këtë sektor ishin të lyera, të pajisura me orënditë e nevojshme për banim. Ky sektor ishte pajisur me një palestër për zhvillimin e aktiviteteve sportive. Tualetet ndodheshin brenda dhomave dhe ishin të pajisura me nga një post dushi. Dhomat e banimit në këtë godinë kishin sipërfaqe rreth 5 m x 3 m.

Në I EVP Durrës dritaret mundësonin ndriçim natyral të bollshëm. Në dhoma sigurohej energji elektrike për ndriçim dhe nevoja të përditshmërisë. Çdo dhomë banimi kishte tualet më vete dhe të burgosurve iu jepeshin detergjente për larje, dezinfektantë e sapunë në mënyrë që të respektoheshin të gjitha protokollet e higjienës.

Ambienti i dhomave të banimit, korridoret e përbashkëta, dushet dhe klasat ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare. Ambientet e përbashkëta të dusheve për

larjen e trupit ishin funksionale nëpër sektorë, ku secili sektor kishte 6 poste dushi, për të bërë të mundur aksesimin me ujë të ngrohtë për larjen e trupit për të gjithë të dënuarit/paraburgosurit.

Institucioni nuk kishte sistem qendror ngrohje/ftohje. Në periudhën e dimrit ngrohja në dhoma realizohej me pajisje elektrike të siguruara nga familjarët e personave të burgosur. Sistemi elektrik dhe hidraulik ishte i amortizuar dhe kërkonte ndërhyrje për riparimin e tij.

Sektori i kujdesit të veçantë (SKV), ndodhej në godinën A, në dy sektorë më vete. Në SKV në katin e parë tualetet ishin të përbashkëta, gjë që e vështirësonte kujdesin e tyre ndaj higjienës personale, ndërsa në sektorin e dytë, të katit të dytë, ambienti i tualeteve ndodhej brenda çdo dhome dhe për arsye sigurie dyert kishin një dritare të vogël që lejonte vëzhgimin dhe kontrollin e të burgosurit nga personeli policor. Bolierët e dusheve të përbashkëta të sektorit të kujdesit të veçantë ndodheshin jashtë këtij ambienti dhe komandoreshin nga personeli i burgut. Kjo zgjidhje ishte në funksion të elementëve të sigurisë, veçanërisht për personat e burgosur që kanë probleme të shëndetit mendor. Aktualisht në IEVP Durrës ndodhen 56 persona me probleme të shëndetit mendor. Avokati i Popullit thekson se për të dënuarit me probleme të shëndetit mendor duhet të tregohet kujdes i veçantë sa i takon përzgjedhjes së standardeve të dhomave ku do të qëndrojnë, ndaj higjienës vetjake të tyre, si dhe të mjedisit që i rrethon.

Në katin e parë të godinës A ndodheshin dhomat e veçimit ku personat e dënuar shlyenin masat disiplinore. Këto dhoma duhet që të plotësojnë të njëjtat kushte dinjitoze për jetesë, ashtu si edhe dhomat e banimit, duke qenë të pajisura me krevat, komodina, tavolinë dhe karrige të fiksuara në dysHEME, të mirëmbajtura dhe të mundësojnë ndriçim artificial. Gjatë inspektimit rezultoi këto dhoma ishin të pajisura me orenditë përkatëse.

Lavanderia e institucionit ndodhej në hyrje të godinës A dhe funksiononte normalisht. Ajo ishte e kompletuar me 1 lavatriçe për larjen e rrobave dhe 1 pajisje për tharjen e tyre. Për të ndihmuar në kryerjen e këtij procesi, institucioni kishte punësuar një të paraburgosur. Nga inspektimi u konstatua se pajisjet ishin në gjendje pune, por sipas pretendimit të të burgosurve ky proces vonohej shumë, ndaj ata preferonin që këtë shërbim ta merrnin nga familjet e tyre. Në këtë kuadër ata kërkonin shtimin me një lavatriçe tjetër për ofrimin sa më parë të këtij shërbimi.

Në IEVP Durrës blerja e produkteve të nevojshme, me kërkesë të të paraburgosurve dhe të dënuarve kryhej nëpërmjet njësisë tregtare online. Njësia tregtare funksionon normalisht, sipas projektit të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Kuzhina e institucionit ishte e pastër dhe e rregullt. Ajo funksiononte në kushte normale, pasi pajisjet e gatimit dhe sistemi i aspirimit ishin të standardeve industriale. Personeli i kuzhinierëve ishte pajisur me kartelat shëndetësore. Menuja javore dhe

norma ushqimore ishin të afishuara. Kampionët ushqimorë ruheshin në kushte frigoriferike, dhe ishin të etiketuar sipas vakteve përkatëse dhe datave. Gjithashtu u konstatuan edhe racionet përkatëse për të sëmurët diabetikë në këtë institucion. Përgjithësisht, kushtet e përgatitjes së ushqimit në ambientet e kuzhinës së institucionit, ishin në gjendje të mirë. Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe të menisë së gatimit ishin të plotësuar sipas rubrikave, të sekretuar dhe të protokolluar.

Regjimi dhe aktivitetet

Gjatë inspektimit u vu re se regjimi ditor në këtë institucion zhvillohej sipas orarit të veprimeve të miratuar nga drejtori i institucionit. Orari i veprimtarive ishte i njëjtë për të gjithë sektorët pavarësisht nga siguria që ata kishin dhe aktivitetet e zhvilluara.

Gjatë inspektimit u vu re se zhvilloheshin aktivitete të përbashkëta nga të cilat mund të përfitonin të dënuarit/paraburgosurit, të cilat ishin kryesisht ndjekja e programeve të televizionit, lojërat e tavolinës, si dhe ndeshjet e futbollit në ambientet e ajrimit. Mungesa e tendave në ambientet e ajrimit ishte problem i vazhdueshëm për të burgosurit, si për periudhën e dimrit, po ashtu edhe të verës. Regjimi ditor dhe aktivitetet zhvilloheshin sipas një programi të miratuar nga drejtori i institucionit.

Në këtë institucion ndodheshin disa ambiente që i shërbejnë qëllimit të ri-integrimit të të burgosurve, si biblioteka, një dhomë ku zhvilloheshin aktivitetet fetare të besimtarëve myslimanë dhe atyre të krishterë, klasa që shërbenin si dhoma për psikologun etj. Në çdo rast në këtë aspekt ka nevojë për një ndryshim thelbësor në sistem, në mënyrë që këto institucione të krijojnë kushte për rehabilitim efektiv.

Biblioteka ishte një mjedis i vogël i pajisur me televizor, stola dhe një raft jo shumë të pasur me libra. Të paraburgosurit dhe të dënuarit e regjistruar kishin nga një kartelë personale dhe nëpërmjet saj tërhiqnin dhe dorëzonin librat.

Në IEVP Durrës kishte një bashkëpunim të vazhdueshëm me Shoqatën Kristiane të të Burgosurve Shqiptarë të cilët kanë zhvilluar aktivitete informuese e edukuese.

Në këtë drejtim është për t'u theksuar se, një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është ri-integrimi në shoqëri i këtyre personave, i cili do të vlejë në momentin kur ata do të lënë burgun. Ndaj, larmia e aktiviteteve që zhvillohen brenda institucionit duhet të jetë e shumëllojhtë, ku në to të përfshihen një masë sa më e madhe e të burgosurve. Për këtë qëllim, Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se: *“Regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në*

ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”⁸.

Në zbatim të detyrimit ligjor, për garantimin e të drejtës për arsimim dhe formim profesional, në IEVP Durrës kishin filluar trajnimet profesionale në bashkëpunim me Drejtorinë/Zyrën Rajonale të Formimit Profesional Durrës të kurseve profesionale, si ai për “Kujdestarin Social”, Gjuhë Italiane, Gjuhë Angleze, si dhe për specialitete hidraulik dhe elektrikist, ku ishin të regjistruar për secilin kurs 10 të burgosur, në bazë të shprehjes së interesit nga ana e tyre. Për sa i përket procesit arsimor, në vijim dhe të marrëveshjes së bashkëpunimit “*Për arsimin e shtetasve në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Republikën e Shqipërisë*”, nr. 3414/1 prot., datë 18.06.2024 për Ministrinë e Drejtësisë dhe nr. 4137/8 prot., datë 18.07.2024 për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me shkresën nr. 91/1 prot., datë 16.06.2025 “*Kërkesë për fillimin e procesit arsimor për vitin 2025-2026 pranë IEVP Durrës*”, IEVP Durrës i është drejtuar Zyrës Vendore Arsimore Durrës për bashkëpunim e zhvillimit të programit mësimor.

Plani individual i trajtimit ishte i hartuar nga sektori i çështjeve shoqërore të institucionit dhe ofrohej prej tyre ose në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për shërbimet e arsimit, formimit profesional, punësimit dhe organizatat jofitimprurëse. Për të burgosurit e rinj të moshës 18 deri 21 vjeç, institucioni kishte përgatitur një plan individual trajtimi, ku përfshihet trajtimi, rehabilitimi dhe ri-integrimi i tyre. Vlerësimi, programimi dhe realizimi i trajtimit bëhej nga personeli i sektorit të edukimit në bashkëpunim dhe me sektorët përkatës të institucionit.

Avokati i Popullit vlerëson zhvillimin e këtyre kurseve dhe insiston në shtimin e tyre duke u dhënë mundësinë personave në paraburgim apo që vuajnë dënimet të kenë përmirësim të njohurive të tyre.

Dosjet personale të të burgosurve ishte të plotësuara rregullisht sipas rubrikave, me përmbledhje nga takimet më vete me të dënuarit dhe të paraburgosurit, programet individuale të trajtimit në të cilat ata kishin marrë pjesë, vlerësimet sipas tre mujorëve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse, për llojin e asistencës së ofruar psikologjike, sociale apo mjekësore. Në dosjet psiko-sociale ishin të evidentuara edhe niveli i riskut referuar gjendjes psiko-emocionale që paraqiste çdo i burgosur, si dhe kohëzgjatja e trajtimit në varësi të qëndrueshmërisë së mendimeve dhe sjelljeve që ata reflektonin gjatë kohës të qëndrimit në këtë institucion.

Tërësia e aktiviteteve të zhvilluara dhe e trajtimeve psiko-sociale individuale dhe në grup me të burgosurit në këtë institucion, kishin si objektiv rehabilitimin, këshillimin dhe mbështetjen psikologjike të tyre.

Ajrimi i të burgosurve realizohej sipas orarit ditor, por për shkak të mënyrës që janë të organizuara godinat në regjimin e brendshëm të institucionit, të burgosurit qëndronin

⁸ Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika 25.1 dhe 25.2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

në ajrim edhe jashtë këtij orari. Në regjimin e brendshëm ndodheshin 2 ambiente ajrimi (çdo sektor më vete) dhe 1 fushë futboll, ku lejoheshin të zhvilloheshin aktivitete sportive me grupe.

Mekanizmi Kombëtar thekson nevojën e vazhdueshme të ndërthurjes së aktiviteteve kulturore-sportive dhe edukative me të burgosurit sipas grupmoshave dhe kategorive, si dhe hartimin e programeve për këshillimin dhe trajtimin individual të këtyre personave, me qëllim që ata të kenë mundësi të ndërveprojnë me njëri-tjetrin, si dhe të mbushin sado pak atë boshllëk psikologjik dhe edukativ, që krijohet tek këta persona nga mungesa e aktiviteteve kulturore dhe sportive me botën jashtë, gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit.

Shërbimi shëndetësor

Organika e stafit mjekësor të IEVP Durrës, është miratuar për 17 punonjës, nga të cilët 2 mjekë psikiatër (prej të cilëve njëri me kohë të plotë dhe tjetri me kohë të pjesshme), 2 mjekë të përgjithshëm (prej të cilëve njëri me kohë të plotë dhe tjetri me kohë të pjesshme), 1 farmacist, 1 mjek stomatolog, 1 kryeinfermier dhe 10 infermierë.

Në regjimin e brendshëm të IEVP-së, u evidentua se ndodhej ambienti i infermierisë që përbëhet nga dhoma e mjekut për kryerjen e vizitave, dhoma e stomatologut, dhoma e urgjencës, ku kryejnë shërbimin 24 orë stafi i infermierëve. Dhoma e mjekut ishte e kompletuar me orenditë e nevojshme si tavolinë pune, karrige, rafte për mbajtjen e medikamenteve, kartelave mjekësore individuale për çdo të burgosur dhe regjistrat mjekësorë.

Po ashtu, dhoma e stomatologut ishte funksionale dhe e pajisur me karrige, sterilizues, si dhe njësinë dentare, e cila përballonte kërkesat e të burgosurve për vizitë apo kontroll mjekësor. Në rastet e ndërhyrjeve kirurgjikale dhe mbushjeve të dhëmbëve, që nuk mund të kryheshin nga stomatologu i institucionit, me kërkesë të të burgosurve dhe rekomandimit të mjekut të institucionit, pas miratimit nga drejtuesi i institucionit, i burgosuri shoqërohej për në klinikat private në qytetin e Durrësit, me shpenzimet që mbulohen nga vetë i burgosuri ose familjarët e tij.

IEVP Durrës, kishte një sektor të kujdesit të veçantë (SKV) të vendosur në një sektor më vete, për trajtimin dhe diagnostifikimin e personave të dënuar/paraburgosur me probleme të shëndetit mendor. Gjendja e personave të paraburgosur/dënuar paraqitej si më poshtë:

- Persona me probleme të shëndetit mendor - 56 të dënuar/paraburgosur;
- Përdorues metadoni -10 të dënuar/paraburgosur;
- Persona të sëmurë kronik - 91 të dënuar/paraburgosur;

Nga këqyrja e dokumentacionit të sektorit shëndetësor, në dhomën e mjekut dhe dhomën e urgjencave ndodheshin kartelat klinike të të burgosurve, regjistri i vizitave mjekësore, regjistri i kufizimeve fizike, regjistri i shërbimit 24 orësh të infermierëve, si dhe regjistri i shpërndarjes të medikamenteve mjekësore për të sëmurët kronikë. Këto

dokumente ruheshin në rafte të veçantë, ishin të sekretuar dhe ishin të plotësuar sipas protokolleve shëndetësore.

Vizitat mjekësore nga mjeku i institucionit, kryheshin sipas procedurave të parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, me kërkesë të të burgosurve dhe miratim të drejtorit të institucionit. Në rastin e vizitave mjekësore pranë mjekëve specialistë në Spitalin Rajonal Durrës, pas dhënies të rekomandimit nga mjeku i institucionit dhe miratimit nga drejtori i institucionit, bëhej planifikimi dhe pacienti shoqërohej nga forcat e sigurisë për kryerjen e vizitave mjekësore.

Pavarësisht situatës pozitive, të burgosurit kërkonin që mjeku i institucionit të ishte më prezent pranë tyre, nëpërmjet konsultave dhe vizitave mjekësore, jo vetëm duke i deleguar për t'u dhënë zgjidhje shqetësimeve që paraqesin, stafit të infermierëve.

Në tërësinë e ankesave, kërkesa për tu vizituar nga mjeku i institucionit, duhej t'i drejtohej nga të burgosurit punonjësit të sektorit psiko-social ose personelit të burgut. Për të garantuar konfidencialitetin e kërkesave të tilla, KPT në vizitën inspektuese në Shqipëri në vitin 2023 ka rekomanduar: *“Të rishikohen masat për aksesin e personelit të kujdesit shëndetësor në burgjet e vizituara në mënyrë që të shmanget që personeli i burgut të veprojë si ndërmjetës”*.

Në vijim të këtij rekomandimi, institucioni i Avokatit të Popullit sugjeron që personeli infermierëve të organizojë vizita ditore të rregullta në ambientet e çdo sektori, për të mbledhur kërkesat për vizita apo konsulta mjekësore nga mjeku i institucionit, ose duke vendosur kutitë e dedikuara për këtë qëllim të mbyllura vetëm për kërkesat për takime me mjekun, ku të kenë akses vetëm anëtarët e personelit shëndetësor të institucionit.

Stafi shëndetësor në IEVP, duhet të tregojë më shumë përgjegjësi dhe profesionalizëm në kujdesin ndaj të dënuarve/paraburgosurve, për arsye të mungesës të alternativave në raport me pjesën tjetër të shoqërisë dhe të izolimit që ata ndodhen. Ndaj në këto kushte, është në detyrën e personelit mjekësor, garantimi i sigurisë së jetës dhe shëndetit të të paraburgosurve, sigurimi i pavarësisë në ushtrimin e detyrës së tyre, si dhe garantimi i sigurisë fizike dhe shërbimet e tjera ndaj të dënuarve/paraburgosurve nga sektorë të tjerë brenda IEVP-së.

Për shoqërimin e të sëmurëve në rastin e vizitave mjekësore apo të urgjencave për në Spitalin Rajonal Durrës, IEVP Durrës ka në dispozicion një automjet ambulancë të re.

Theksojmë se, institucioni ishte i furnizuar me sasinë e nevojshme të medikamenteve të urgjencës dhe për të sëmurët kronikë, të cilat shpërndaheshin nga stafi shëndetësor i infermierëve, sipas rekomandimit të mjekëve specialist. Gjithashtu, të burgosurit ishin të pajisur me librezat shëndetësore, e cila e shoqëronte të burgosurin gjatë transferimeve nga njëra IEVP në tjetrën.

Skema e rimbursimit të ilaçeve për të sëmurët kronikë, funksiononte sipas kontratës tre palëshe të lidhur mes FDSKSH-së, depos farmaceutike dhe institucionit, e cila i

referohej historikut të sëmundjeve për çdo të dënuar dhe të paraburgosur, si dhe kartelave shëndetësore të të burgosurve të plotësuar nga mjeku i institucionit. Njëkohësisht, furnizimi me ilaçe i institucionit kryhej periodikisht nga sektori i shëndetësisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, si dhe blerjes së drejtpërdrejtë të medikamenteve me fondet e akorduara në buxhetin e institucionit.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b, të ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.”*.

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave për zbatimin e projektit për rikonstruksionin e plotë të godinës së IEVP Durrës, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ligjin nr. 81, datë 25.06.2020, *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”*, për të siguruar ambiente të përshtatshme dhe dinjitoze në ofrimin e shërbimeve të të burgosurve sipas akteve ligjore në fuqi.
2. Marrjen e masave për instalimin e një sistemi qendror për ngrohje/ftohje të ambienteve të brendshme të dhomave të banimit të të dënuarve/paraburgosurve dhe për heqjen e pajisjeve ngrohëse elektrike, të cilat përbëjnë rrezik për jetën e këtyre personave.
3. Të merren masa për të adresuar problematikën e numrit të lartë të të dënuarve që qendrojnë në këtë institucion paraburgimi ose duke ndryshuar Urdhrin për kategorizimin e IEVP-ve ose nëpërmjet lëvizjeve të tyre në IEVP të cilët akomodojnë vetëm të dënuar.
4. Të merren masa të menjëhershme, për akomodimin e personave të moshës 18-21 vjeç në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualin e sigurisë për këtë kategori ose të udhëzohet marrja e një miratimi/mendimi me shkrim prej të burgosurve nën 21 vjeç.
5. Marrjen e masave të menjëhershme, për vendosjen e mbulesave të bokseve të ajrimit, për të ndaluar futjen e ujit në kohë me shi.

6. Marrjen e masave të menjëhershme nga sektori i sigurisë të institucionit, për heqjen e litarëve në dhomat e banimit që përdoren nga të burgosurit për tharjen e rrobave, si element që cënon sigurinë, por edhe si mjet që mund të përdoret për dëmtimin e jetës, kryesisht nga persona që kanë probleme me shëndetin mendor dhe krijimin e një lavanderie për këtë qëllim.
7. Marrjen e masave për shtimin e ambienteve të përbashkëta me qëllim rritjen e numrit të aktiviteteve në mënyrë që të paraburgosurit/dënuarit, të kenë aktivitete të shumta edukative, sportive dhe të mundësohet që të zhvillojnë edhe aktivitete tjera, me të cilat shprehin talentin në punën dhe zanatet që zotërojnë.
8. Të merren masa të menjëhershme nga stafi i sektorit shëndetësor të institucionit, me qëllim që të kontaktojnë çdo ditë me të burgosurit, për marrjen e kërkesave të tyre për vizita mjekësore apo për konsulta me mjekun e institucionit.
9. Të merren masa të menjëhershme, për dhënien e një shërbimi shëndetësor efikas dhe dinjitoz pacientëve që kanë probleme shëndetësore, si dhe nevojës për të kryer vizita mjekësore te mjekët specialistë, pranë qendrave spitalore, por edhe në QSB Tiranë.
10. Marrjen e masave të menjëhershme, për plotësimin në sektorin e policisë, kryesisht në pozicionin e specialistit të policisë të rolit të mesëm (3 oficerë) dhe 7 specialistë të rolit bazë, që ndikojnë në nivelin e gadishmërisë dhe të sigurisë të këtij institucioni.
11. Të merren masa menjëhershme, për ndryshimin e menisë së ushqimit për ta bërë atë sa më të larmishme dhe përshtatjen e vakteve ushqimore, sipas normave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore, për trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve, gjendjes shëndetësore, kushteve klimaterike, besimit fetar dhe nevojave të veçanta të tyre.
12. Marrjen e masave, për pajisjen e lavanderisë me lavatriçe shtesë, për ofrimin sa më parë të këtij shërbimi, në mënyrë që të jetë në proporcion me numrin e personave të akomoduar.
13. Marrjen e masave të nevojshme, për garantimin e kushteve për trajtimin me dinjitet të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, respektimi i të drejtave dhe të lirive themelore të tyre, gjatë kryerjes së vizitave mjekësore dhe ruajtja e privatësisë të të burgosurve gjatë ekzaminimit shëndetësor në qendrat spitalore, për të përmbushur më së mirë qëllimin e ligjit nr. 81/2020, *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*.

Në bazë të nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtyre rekomandimeve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

Ahmet PRENÇI
dv